



Prishtinë, 28 shkurt 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1110_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084),
- Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja,
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_755_2016 të datës 28 janar 2016 për shoqërinë "Hidroenergji" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, Lokacioni "Sllatinë" ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V_755_2016 i datës 28 janar 2016 i Modifikuar me Vendimin V_919_2017 edhe për 1 (një) vit, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut, të datë 21.01.2019 nr. prot. 056/19 të shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., me adresë rruga "Dëshmorët e Kombit" pn,- Ferizaj, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 shkurt 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V_755_2016 i datës 28 janar 2016, i vazhduar me vendimin V_930_2018 të datës 29 mars 2018 dhe i Modifikuar me Vendimin V_919_2017, për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, Lokacioni Sllatinë, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut, edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri me **28 janar 2020 për përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 03.06.2013 nga shoqëria "Hidroenergji" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3, me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, në Lokacionin "Sllatinë", Komuna e Kaçanikut, Republika e Kosovës.



- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar me datë 06 shtator 2013 Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_558_2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 15.07.2015 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, në lokacionin ZK Sllatinë, Komuna e Kaçanikut, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 28.01.2016 ka vendosur që shoqërisë “Hidroenergji” SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V_755_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc, për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, Lokacioni ZK Sllatinë Komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë 28 prill 2017 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikim të Autorizimit Final për ndryshim vetëm të kapacitetit instalues të Hidrocentralit në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3, nga kapaciteti instalues prej 8.5 MW në kapacitetin instalues prej 9.998 MW, ZK Sllatinë, Komuna e Kaçanikut.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 10.05.2017 ka vendosur me Vendimin V_919_2017 për Modifikimin e Vendimit të Autorizimit Final V_755_2016 të datës 28 janar 2016, lëshuar shoqërisë “Hidroenergji” SH.P.K., për Hidrocentralin në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3 nga kapaciteti instalues prej 8.5 MW, në kapacitetin total të instaluar prej 9.998 MW, sipas Vendimit nr. 3753-3/16 –ZSP- 521/2017 dt. 26.04.2017 për lejimin e ndryshimit të vendimit mbi vazhdimin e lejes ujore nr. 3684/12-ZSP-70/13, të datës 17.01.2013, vetëm në rritjen e kapacitetit instalues prej N=8.5 MW në N=9.998 MW në segmentin lumor nga Kuota Z=706.80 m.l.m e veprës së marrjes, deri në Kuota Z=565.5 m.l.m. ndërtesa e HC Lepenci 3, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- ZRRE me datë 28.12.2017 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_755_2016 të datës 28 janar 2016, të Modifikuar me Vendimin V_919_2017 për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, **për vazhdimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019.**
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Hidroenergji” SH.P.K., dhe me vendimin V_930_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të vendimit për autorizimin Final V_755_2016 të datës 28 janar 2016 edhe për një (1) vit,



gjegjesisht deri me 28 janar 2019, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e Autorizimit.


- ZRRE me datë 21.01.2019 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar kërkesë për vazhdim të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_755_2016 të datës 28 janar 2016, i vazhduar me Vendimin V_930_2018 të datës 29 mars 2018, për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, për një afat shtesë për zgjatjen e periudhës së ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjesisht deri me 28 janar 2020.
- Shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., në kërkesë e saj ka sqaruar se: pas pranimit të vendimit për autorizimin final menjëherë kanë filluar me përgatitjet e fillimit të punimeve në ndërtimin e Hidrocentralit HC Lepenci 3, duke filluar me matjet gjeodezike nga expert të fushës, janë bërë përgatitjet për hapjen e rrugës, trasesë së tubacionit dhe ndërtesës së Hidrocentralit. Ka sqarua se, edhe përkundër vullnetit për finalizimin sa më të shpejt të projektit në ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese është detyruar që ti drejtohet ZRRE-së, për mundësin e shtyrjes së vlefshmërisë së Autorizimit Final për HC Lepenci 3, edhe për një vit për mundësin e finalizimit të projektit.
- Arsyeja e kërkesës për shtyrje të afatit për periudhën një vjeçare për HC Lepenci 3 është se kanë pasur të bëjnë me një territor të vështirë, ku deri me tani i ka përfunduar të gjitha punimet, hapja e trasesë dhe vendosja e tubacionit është përfunduar, janë vendosur/montuar dhe lidhur tubacioni, është përfunduar dhe finalizuar vepra e marrjes, është përfunduar ndërtesa e hidrocentralit, janë montuar dhe lidhur turbinat, s’bashku me të gjitha pjesët përcjellëse teknike dhe teknologjike, si dhe është përfunduar largpërçuesi dhe është duke u finalizuar edhe lidhja në nënstacionin e Sinkaporit në Kaçanik, dhe nga kjo situatë mund të sigurojnë se deri më tani janë përfunduar më shumë se 90 % të punëve në teren.
- Arsye tjetër e shtyrjes së afatit për periudhën një vjeçare për HC Lepenci 3 është paraqitur nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., se kanë pasur të bëjnë me një terren të vështirë, ku ka pasur rrëshqitje të dheut nga uji i madh, shirat e vazhdueshëm nga moti i papërshtatshëm për zhvillimin e punëve normale në këtë periudhë të dimrit dhe pranverës ku është dashur të punohet me kujdes dhe herë herë edhe të ndalohen punimet për të evituar edhe pasojat, kapaciteti i këtij hidrocentrali është më i madhi i ndërtuar deri më tani përmes procedurës së Autorizimit, specifikave të terrenit dhe specifikave të projektit, i kanë detyruar që të jenë të kujdesshëm pasi që vlera e projektit është mjaft e madhe dhe rreziqet është dashur të kihen parasysh, dhe të gjitha këto iu kanë shkatuar vonesa në përfundimin e këtij projekti, e për të cilën kanë kërkuar që t’iu mundësohet shtyrja nga ZRRE-ja, për finalizimin e këtij projekti.
- Andaj, shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka theksuar se marr parasysh të gjitha faktet e cekura më lartë, lusin Bordin e ZRRE-së, që bazuar në dispozitat e nenit të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në fuqi në datën lëshimit të vendimit për autorizimin final V_755_2016 i shtyrë me vendimin V_930_2018 të datës 29 mars 2018 dhe të modifikuar me Vendimin V_919_2017 për ndërtimin e hidrocentralit HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, të ju lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final për ndërtimin e hidrocentralit edhe për një (1) vit, pasi që vonesat për mos përfundimin e projektit deri më tani kanë ardhur nga faktorët e ndryshëm të natyrës dhe terrenit të pa përshtatshëm dhe brenda këtij afati do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të finalizuar projektin në fjalë dhe afateve ligjore të lejueshme.



- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., dhe dëshmive të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Lepenc HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, në Komunën e Kaçanikut, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se kërkesa është e bazuar pasi që ndërtimin i kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentralet është mjaft e vështirë për shkak të terreneve, kushteve klimatike dhe kompleksitetit të këtyre projekteve, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_755_2016 i datës 28 janar 2016, Vendimit V_930_2018 të datës 29 mars 2018 dhe të Vendimit mbi Modifikimin e Autorizimit V_919_2017, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_755_2016 i datës 28 janar 2016, do të vlen deri me datë **28 janar 2020** sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rüşiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kaçanik,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së